MRI/ Tentoi t'i largohej policisë dhe hodhi armën nga dritarja e makinës, arrestohet i riu në Elbasan

05 Prill, 2022 11:19



Madhësia e tekstit:

Një 34-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi u kap me armë.

Burime zyrtare bënë me dije se në kuadër të operacionit të koduar "Unexpected" pas hekurave përfundoi shtetasi me Bledar Goguja, banues në Elbasan.

NJOFTIMI I POLICISË

Sekuestrohet 1 armë zjarri dhe municion luftarak.
Vihet në pranga shtetasi që e posedonte armën.
Në zbatim të planit të masave për kontrollin e territorit, me qëllim kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri, lëndë narkotike, si dhe për parandalimin e ngjarjeve kriminale, bazuar dhe në informacionet e marra më parë, strukturat hetimore dhe operacionale në DVP Elbasan, Komisariatit të Policisë Elbasan, në bashkëpunim me FNSH, Fier, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Unexpected".
Në kuadër të këtij operacioni u ushtruan dhjetëra kontrolle të befasishme në rrugë dhe në ambiente të ndryshme. Si rezultat i këtyre kontrolleve u kap dhe u arrestua në flagrancë, te stacioni i trenit në lagjen "Sul Paprri", në Elbasan shtetasi B. G., 34 vjeç, banues në Elbasan.

Ky shtetas qarkullonte me një automjet dhe sapo ka parë Policinë që e ndiqte, pasi disponohej informacion se kishte armë zjarri me vete, ka hedhur armën dhe ka tentuar të largohet, por është kapur nga punonjësit e policisë dhe është vënë në pranga.
Gjatë operacionit janë shoqëruar për verifikim edhe disa persona të tjerë me precedentë penal, të cilët pas verifikimeve, janë lënë të lirë.
Vijon puna për dokumentimin e plotë të veprimtarive kriminale në të cilat ky shtetas mund të jetë i implikuar.
Materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arrestim Elbasan

TË NGJASHME


FOTO/ Aksident në aksin Elbasan-Librazhd, furgoni përplaset me dy kamionë, plagoset drejtuesi
31 Mars, 2022


Dhunoi gruan dhe e kërcënoi me armë zjarri, arrestohet 44-vjeçari në Elbasan
31 Mars, 2022

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË


Detajet e reja/ Zbulohet emri i viktimës në atentatin e autostradës. Si ndodhi vrasja
04 Prill, 2022


Vrasja në autostradë, Policia jep detajet e para të ngjarjes
05 Prill, 2022


Pamjet nga vendngjarja, momentet e para pas vrasjes së 35 vjeçarit
05 Prill, 2022


FOTO/ Autoambulancë dhe policë, pamje nga vendi ku u gjet i vrarë i riu në Tiranë
05 Prill, 2022


Të shtënat me armë zjarri në rrugën dytësore Tiranë-Durrës, gjendet i pajetë brenda mjetit 35-vjeçari
05 Prill, 2022



"Jam beqar, por bashkëjetoj dhe kam 3 fëmijë", zbardhet dëshmia e Alqi Bllakos në gjykatë dhe enigma se pse s'u pyet se ku ishte para arrestimit
05 Prill, 2022

KATEGORIA VIDEO


VIDEO/ Sa shumë emocione! Fitorja spektakolare nga këndi i "luftëtarit" Florian Marku
05 Prill, 2022


FOTO+VIDEO/ Rrëshqitje dherash pa ndalim, vështirësohet puna për pastrimin dhe hapjen e Rrugës së Arbrit
05 Prill, 2022


VIDEO/ Alarmoi policinë, ja çfarë u gjet në valixhen e braktisur në Fier
05 Prill, 2022


VIDEO/ Valixhja e dyshimtë në Fier, e gjithë zona e qendrës e rrethuar, ja pamjet nga vendi i ngjarjes
05 Prill, 2022


Uji i Ftohtë "Tepelenë", uji shqiptar i pastër, i freskët, i certifikuar ndërkombëtarisht
02 Prill, 2022


VIDEO/ Shehi dhe Longo luajnë "shah", nuk ka "krisma" në supersfidën Kukësi-Tirana, dy ekipet ndalen te shtyllat
02 Prill, 2022

Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT


Detajet e reja/ Zbulohet emri i viktimës në atentatin e autostradës. Si ndodhi vrasja
04 Prill, 2022


Vrasja në autostradë, Policia jep detajet e para të ngjarjes
05 Prill, 2022


Pamjet nga vendngjarja, momentet e para pas vrasjes së 35 vjeçarit
05 Prill, 2022


"Donald Lu organizoi komplot për të më rrëzuar", akuza e fortë e kryeministrit pakistanez për ish ambasadorin e SHBA në Shqipëri
05 Prill, 2022


FOTO/ Autoambulancë dhe policë, pamje nga vendi ku u gjet i vrarë i riu në Tiranë
05 Prill, 2022


Rusët s'kanë aspak mëshirë, vriten të tjerë civilë në Kharkiv
05 Prill, 2022

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2022 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.